



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

**RAPORTI NGA PROCESI I KONSULTIMIT PËR KONCEPT DOKUMENTIN
PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE**

Korrik 2018

Hyrje

Hartimi i Koncept Dokumentit për Procedurën Kontestimore është paraparë në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë, për vitin 2017 në kuadër të Prioritetit Strategjik të Qeverisë Nr. 2. Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit objektivit 2.1 “Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe fuqizimi i të drejtave pronësore”, “Unifikimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e të drejtave pronësore.

Kjo çështje është e ndërlidhur me Strategjinë Kombëtare për të Drejtat Pronësore (SKDP), aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 18 janar 2017, e cila ka për qëllim sigurimin e të drejtave pronësore duke e forcuar kuadrin ligjor dhe duke adresuar informalitetin në sektorin e pronës së paluajtshme. Po ashtu është e ndërlidhur me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 e cila parasheh masa konkrete për ta adresuar jo efikasitetin e gjyqësorit.

Plani për rishikimin e kësaj fushe është në përputhje me qëllimin strategjik të Qeverisë së Republikës së Kosovës për anëtarësim në BE dhe përmbushjen e kërkesave të pranimit për një reformë intensive, efektive dhe të vazhdueshme të sektorit të drejtësisë. Qëllimi i këtyre reformave është harmonizimi i legjislacionit kombëtar me *Acquis* të BE-së dhe zbatimi i standardeve dhe praktikave më të mira të BE-së.

Synimi i përgjithshëm i këtij koncept dokumenti është që të adresohen problemet e identifikuara në aplikimin e Ligjit aktual për Procedurën Kontestimore, i cili në disa pjesë, ka vështirësi dhe si rrjedhojë nuk është i përshtatshëm për zbatim, si dhe rregullimin dhe definimin e qartë të normave të procedurës civile me qëllim të rritjes së efikasitetit të procedurave gjyqësore kontestimore.

Hartimi i draft Koncept Dokumentit është bërë nga Grupi Punues i udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë. Pjesëmarrës të tjerë në Grupin Punues, për hartimin e dokumentit në fjalë ka qenë edhe Programi për të Drejtat Pronësore.

Hartimi i draft Koncept Dokumentit është mbështetur nga ana e ekspertëve të USAID-it, Programi për të Drejtat Pronësore në Kosovë. Finalizimi i draft Koncept Dokumentit për Procedurën Kontestimore, është pasuar nga procesi i konsultimit i cili është bërë në formë elektronike. Mundësinë për të dhënë komente e kanë pasur të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe ekspertë të ndryshëm përmes platformës elektronike të publikuar në web faqen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Konsultimi i këtij draft Koncept Dokumentit është bërë në pajtim të plotë me Rregulloren Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik. Prosesi i konsultimit po ashtu është mbështetur nga USAID-i, Programi për të Drejtat Pronësore në Kosovë.

Ecuria procesit të konsultimit

Koncept Dokumenti për Procedurën Kontestimore është publikuar për konsultim me publikun në platformën elektronike për konsultimet me datë 24/05/2018 dhe ka qenë e hapur për komente deri me datë 14/06/2018. Sipas Rregullores për standardet minimale të konsultimit publik, Draft Koncept dokumenti në fjalë është publikuar së bashku me Dokumentin e Konsultimit për Koncept dokumentin i cili në formë të shkurtër ka paraqitur informatat e përmbledhura për Koncept dokumentin, qëllimet, objektivat, opsionet dhe hapësirën për konsultim, informatat për hapat pas përfundimit të procesit të konsultimit etj.

Përveç publikimit të dokumenteve për konsultim, Ministria e Drejtësisë ka dërguar me shkrim në mënyrë elektronike Koncept Dokumentin për konsultim tek institucionet publike (të përfshihen kategoritë e palëve të interesit p.sh. Komuna, Institucionet e pavarura, OJQ etj.

Konsiderohet se konsultimi me shkrim dhe përmes platformës elektronike, kanë qenë mjet i përshtatshëm për të marrë të gjitha kontributet nga ana e palëve të interesit, duke marrë gjithashtu parasysh edhe natyrën e tyre dhe interesat që prek draft Koncept Dokumenti për Procedurën Kontestimore.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim / në mënyrë elektronike;	15 ditë pune	1
2. Publikimi në ueb faqe/Platforma elektronike	15 ditë pune	2
3. Takimet publike		0

Përmbledhje e kontributeve të pranuar gjatë procesit të konsultimit

Kontributet për draft Koncept dokumentin për Procedurën Kontestimore janë dhënë me shkrim nga palët e interesit përmes komunikimit të drejtpërdrejtë nga ana e palëve të interesit, d.m.th përmes e-mail-it. Përmes e-mail-it janë dhënë propozime nga zyra e UNHCR-së në Kosovë, nga Organizata Joqeveritare 'Advancing Together' dhe nga një qytetarë palë e interesit.

Çështje tjera

Me qëllim të finalizimit të Draft Koncept Dokumentit për Procedurën Kontestimore dhe shqyrtimit të komenteve të pranuar, është mbajtur takimi përmbyllës i Grupit Punues. Të gjitha kontributet e pranuar janë shqyrtuar veç e veç, ndërsa raporti i

detajuar për komentet e pranuar, kontribuuesit dhe statusin e kontributeve janë paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 ë këtij raporti.

Hapat e ardhshëm

Draft Koncept Dokumenti për Ligjin për Pronësi dhe të Drejtat tjera Sendore është finalizuar, dhe procedohet për miratim në Qeveri.

Shtojca – tabela e detajuar me informatat për kontribuuesit, arsyetimet për përgjigjet e pranuar dhe të refuzuara.

Koncept Dokumenti për Procedurën Kontestimore				
TEMAT E KONSULTIMIT DHE SHQYRTIMI I OPCIONEVE				
Temat e konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Statusi i Komenteve - pranuar, pjesërisht pranuar, nuk është pranuar	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
TEMA 1: Rishikimi i Dispozitave Themelore	Nuk ka.			
Tema 2 : Barra e provës në procedurën kontestimore	Nuk ka.			

TEMA 3: Përjashtimi i gjyqtarit	<p>Nuk ka.</p>			
Tema 4: Palët dhe përfaqësimi i palëve në procedurën kontestimore	<p>Opcioni 2 ne projektligj është i papërshtatshem sepse po ia kufizon te drejtat palëve për shkak te kufizimit te përfaqesimit ne shkalle te dyte dhe te trete. Personalisht kam nje lende-kontest pronësore ne gjykatën e apelit dhe ate jam duke e përfaqesuar vete. Nëse kalon opëioni 2 ne ligj atëher mua domosdo do te me duhet te angazhoj avokat e për një gjë te tille nuk kam mundësi buxhetore. Si pasoj e mungesës se financave te mia druaj se do ta humbas kontestin për shkak te mospasjes se mundësisë se përfaqesimit. Ju kisha sugjeruar qe ne kontestet civile të mund te përfaqesoj çdo pale e cila e ka zotësinë e plote te veprimit ne gjykatën themelore, te apelit dhe supreme.</p>	<p>Fadil Sinanaj – qytetar</p>	<p>Nuk është pranuar</p>	<p>Koncept Dokumenti trajton problemin e përfaqësimit të dobët të palëve në procedurë dhe si problem kryesor konsiderohet se është ligji aktual që lejon palët të përfaqësohen nga çdo person që ka aftësi të plotë për të vepruar. Opsioni i rekomanduar kufizon mundësin e përfaqësimit nga persona jokompetent për të përfaqësuar së paku në instanca më të larta gjyqësore më qëllim të rritjes së efikasitetit të procedurës dhe mbrojtjes së interesave të palëve. Nuk e detyron palën të këtë avokat por nëse zgjedh të përfaqësohet nga personi i autorizuar atëherë ai duhet të jetë avokat.</p>
Tema: 5 Të rishikohen dispozita për dërgimin e shkresave.	<p>Nuk ka.</p>			

Tema: 6 Dispozitat që kanë të bëjnë me seancat dhe afatet të rishikohen dhe ndryshohen.	Nuk ka.			
Tema: 7 Të rishikohen dispozitat që kanë të bëjnë me procesverbalet	Nuk ka.			
Tema: 8 Vendimet Gjqësore	Nuk ka.			

<p>Tema: 9 Dispozitat e ankesës dhe arsyet për ankesë duhet të rishikohen.</p>	<p>Nuk ka.</p>			
<p>Tema: 10 Të rishikohen Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes.</p>	<p>Nuk ka.</p>			
<p>Tema: 11 Të ndryshohen dispozitat që kanë të bëjnë me përgatitje e shqyrtimit kryesor.</p>	<p>Nuk ka.</p>			
<p>Tema: 12 Shpenzimet Procedurale</p>	<p>Rishikimi i nenit 450 duhet të jetë në përputhshmëri me Strategjinë Nacionale për të Drejtat Pronësore e miratuar nga ana e Qeveris së Republikës së Kosovës në Dhjetor të vitit 2017. Kjo Strategji parasheh që personat e zhvendosur në kushte të rënda shoqëro-ekonomike duhet të</p>	<p>OJQ “Advancing Together”- Prishtinë UNHCR</p>	<p>Është pranuar</p>	<p>Neni 450 i LPK do të rishikohet në pajtim me rekomandimet e Strategjisë Nacionale për të Drejtat Pronësore.</p>

	<p>përrjashtohen nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore dhe thekson se prona e uzurpuar e personave të zhvendosur nuk duhet të llogaritet si pasuri personale, dhe kjo kategori e qytetarëve duhet të lirohet nga pagesa në rastet e çështjeve pronësore për kontestet e krijuara pas konfliktit në Kosovë.</p> <p>Në bazë të drejtës ndërkombëtare, respektivisht parimeve të “Pinheiro”, përrjashtimi nga shpenzimet gjyqësore duhet të përrfshij jo vetëm rastet e Agjencia Kosovare për Verifikim dhe Krahësim të Pronës, por të gjithë personat e zhvendosur që kanë çështje pronësore si rezultat i konfliktit në Kosovë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shtetet duhet të sigurojnë që të gjitha aspektet e procesit të kërkesave për kthimin e pronave, përrfshirë procedurat e apelimit, të janë në kohë, të arritshme, pa pagesë, dhe janë të ndjeshme ndaj moshës dhe gjinisë ... " - Shtetet duhet të sigurojnë që procesi i kërkesave për kthimin e pronave të jetë i qasshëm për refugjatët dhe personat e tjerë të zhvendosur pavarësisht nga vendbanimi i tyre gjatë periudhës 			
--	---	--	--	--

	<p>së zhvendosjes, duke përfshirë vendet e origjinës, vendet e azilit ose vendet në të cilat kanë ikur. Shtetet duhet të sigurojnë që të gjithë personat e prekur janë të vetëdijshëm për procesin e kërkesave për kthimin e pronave dhe se informacioni në lidhje me këtë proces të jetë i disponueshëm, duke përfshirë vendet e origjinës, vendet e azilit ose vendet në të cilat kanë ikur.</p> <p>Personat e zhvendosur për shkak të konfliktit kanë të drejtë të kthehen në pronat e tyre të paluajtshme, e drejtë kjo universale dhe e njohur nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj, nga e drejta ndërkombëtare dhe Kushtetuta e Kosovës.</p>			
<p>Tema: 13 Procedura e kontesteve me vlerë të vogël</p>	<p>Nuk ka.</p>			
<p>Tema: 14 Të parashihet procedurë e</p>	<p>Nuk ka.</p>			

veçantë për të
drejtat
pronësore.

--	--	--	--	--